



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 772/4 prot.

Tiranë, më 07. 10. 2025

V E N D I M

Nr. 233, datë 07. 10. 2025

Bazuar në ligjin 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 114, datë 14.05.2025, e paraqitur nga I. Gj. dhe M. Gj., kundër Shoqërisë së transportit ndërqytetës “Beam” shpk, me pretendimin për diskriminim për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Bazuar në ankesën e paraqitur pranë Komisionerit nga I. Gj., pretendohet se në datë 04.05.2025, së bashku me bashkëshorten e tij, M. Gj., kanë udhëtuar drejt Tiranës në linjën e transportit ndërqytetës Bilisht-Tiranë, me autobusin me targë AA 464 OO. Janë nisur nga qyteti i Bilishtit në orën 12:00 dhe kanë mbërritur në terminalin e autobusëve të juglindjes, pranë Qendrës Tregtare TEG, në orën 16:00. Sipas tyre, autobusi kishte fatorino, por pagesat e biletave i mbledhte drejtuesi i autobusit (shoferi). Duke qenë se ai është person i verbër dhe bashkëshortja me aftësi të kufizuara, në momentin që kanë zbritur nga autobusi, i është kërkuar të paguajnë biletën e plotë të transportit, duke mos iu njohur e drejta për të udhëtuar duke paguar 50 % të çmimit të biletës, sipas parashikimeve ligjore për personat e verbër dhe ata me aftësi të kufizuara.

Sipas ankuesit, nga ana e shoferit i është thënë se nuk e njeh ligjin dhe i ka detyruar të paguajnë biletën e plotë, prej 1600 lekë të reja për vete dhe bashkëshorten e tij.

Subjektet ankues, kërkojnë nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të tij për shkak të aftësisë së kufizuar nga ana e Shoqërisë së Transportit “Beam” sh.p.k. dhe eliminimin e pasojave të ardhura si rezultat i diskriminimit.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

Bazuar në nenin 7, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, *mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprimi të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë*, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash.

1. Me shkresën Nr. 772/1 prot., datë 28.05.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga Shoqëria “Beam” shpk, lidhur me pretendimet e subjekteve ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Informacion nga ana e Shoqërisë “Beam” sh.p.k, lidhur me situatën e pretenduar nga ana e ankuesit.
- Informacion lidhur me dokumentin që ka paraqitur subjekti ankues, I. Gj. – cilën nga librezat e verbërisë ka paraqitur para drejtuesit të autobusit: Librezën e lëshuar nga Shërbimi Social Shtetëror apo Librezën e Verbërisë të lëshuar nga Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”?
- Informacion nëse nga ana e Shoqërisë “Beam” sh.p.k, ofrohet transporti i personave me aftësi të kufizuara, në veçanti personave të verbër dhe atyre me aftësi të kufizuara, bazuar në lehtësirat financiare të parashikuara në Udhëzimin e Ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 5627, datë 18.11.2016 “*Për përcaktimin e kriterëve, rregullave dhe dokumentacionit për lëshimin e licencave dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve brenda vendit*”.
- Kopje të Licencës “*Për kryerjen e shërbimeve të rregullta ndërqytetës të transportit rrugor të udhëtarëve brenda vendit*”.
- A është paraqitur më parë ndonjë ankesë pranë Shoqërisë suaj, si në rastin konkret? Nëse po, cilat janë masat e ndërmarra nga ana juaj? Parashtrime dhe kopje të akteve provuese, nëse ka.

Në përgjigje sa më sipërcituar, përmes shkresës¹ datë 05.06.2025, Shoqëria “Beam” shpk vuri në dispozicion informacionin e kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...*Lidhur me problemin e ngritur nga ana Juaj, për personat me aftësi të kufizuar, I. Gj. dhe M. Gj. është i drejtë. Veprimi i drejtuesit të mjetit bie në kundërshtim me ligjin 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.*

Drejtuesi i mjetit, ku i ka ndodhur veprimi, është i ri në shoqërinë tonë dhe për këtë nuk është i njohur sa e si duhet me ligjet e rregullat për udhëtimin e personave me aftësi të kufizuar. Për këtë veprim, u thirr personi dhe e pranoi veprimin, duke u justifikuar se nuk e dinte një favor të tillë që duhet tu bëhej personave me aftësi të kufizuar. Nga ana jonë, megjithëse ai bën autokritikë, u morr masë me një vërejtje me paralajmërim për pushim nga puna dhe në rast përsëritje do të pushohet nga puna. Drejtuesi i mjetit, mbasi pranoi veprimin, premtoi se të dy personat, në rast se do të udhëtojnë me këtë mjet në këtë linjë, do të udhëtojnë falas.

Në shoqërinë tonë, gjatë gjithë kohës nuk kemi patur asnjë informacion për një veprim të tillë. Duke marrë shkas nga ky veprim, iu bë e njohur të gjithë punonjësve të tjerë ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, për njohjen e favoreve që përfitojnë personat me aftësi të kufizuar.

Me analizën që iu bë rastit me të gjithë punonjësit e shoqërisë, në të ardhmen në subjektin tonë nuk do të ketë veprime të tilla, do të zbatohen me përpikmëri të gjitha ligjet e rregullat që përfitojnë personat me aftësi të kufizuar.

Me njoftimin e bërë nga ana Juaj, na keni ndihmuar për të parandaluar veprime të tilla për të ardhmen”.

2. Bazuar në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “ 8. Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar.”, për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri vlerësoi të nevojshme realizimin e seancës dëgjimore mes palëve. Në këtë kuptim me anë të shkresës nr. 772/3 prot., datë 06.08.2025 “Njoftim për seancë dëgjimore”, Komisioneri njoftoi palët lidhur me zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 14.08.2025.

Mbështetur në njoftimin e realizuar, palët informuan Komisionerin për pamundësinë për të marrë pjesë në seancën dëgjimore të caktuar.

Sa më sipër dhe referuar informacionit të paraqitur, Komisioneri vlerëson se, kërkimi i palës ankuese, ose ajo që pala ankuese kërkon të arrijë ose të sigurojë, nëpërmjet paraqitjes së ankesës objekt shqyrtimi dhe fillimit të kësaj procedure administrative është përmbushur, nëpërmjet ofrimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin e tyre në linjat urbane ndërqytetëse, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, me 50 % të çmimit të biletës.

Në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar përcaktohet: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, komisioneri zbaton normat

¹ Protokolluar pranë Komisionerit me nr. 772/2 prot., datë 16.06.2025.

e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj.”

Neni 90, pika 3, të Kodit të Procedurave Administrative (K.P.A), ka parashikuar se: *“Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.*

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se qëllimi për të cilin procedimi administrativ ka filluar mbi bazën e ankesës së palës ankuese është përmbushur në thelb, pasi u zgjidh problematika e adresuar pranë Komisionerit.

Për rrjedhojë është përmbushur edhe qëllimi i ligjit 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, për sigurimin e të drejtës së çdo personi për:

- “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji;*
- b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike;*
- c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.*

Përfundimisht, referuar sa më sipër, si dhe duke mbajtur në konsideratë:

- Masat efektive konkrete të ndërmarra nga ana e shoqërisë “Beam” shpk, përmes ofrimit të lehtësirave sa më sipër cituar, lidhur me udhëtimin e PAK, në linjat ndërqytetëse, me gjysmën e çmimit të biletës;
- Përmbushjen e qëllimit për të cilin ishte iniciuar ankesa konkrete, si dhe
- Qëllimin parandalues të LMD-së, ndërgjegjësimin e ndërmjetësimin për zgjidhje miqësore e zbatim efektiv të tij, dhe jo vetëm karakterin konstatues dhe ndëshkues të vendimmarrjeve të KMD-së;

Komisioneri arrin në përfundimin se, procedura administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 114, datë 14.05.2025, të paraqitur nga I. Gj. dhe M. Gj. kundër linjës së transportit të udhëtarëve “Beam” shpk, duhet të deklarohet e përfunduar, pa një vendim përfundimtar, për sa kohë që objekti dhe qëllimi që pala ankuese ka kërkuar të realizojë nëpërmjet kësaj procedure administrative është përmbushur².

² Për analogji citojmë vendimet e KMD-së: Nr. 3, datë 06.01.2025.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” dhe nenet 32 e 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 114, datë 14.05.2025, të I. Gj. dhe M. Gj. pa një vendim përfundimtar, pasi është arritur qëllimi dhe efektiviteti për të cilin ka filluar procedura administrative.
2. Rekomandohet që Shoqëria e Transportit të udhëtarëve “Beam” shpk, me NIPT K22313004H, me qëllim parandalimin e situatave dhe sjelljeve diskriminuese gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj dhe ofrimit të shërbimit të transportit, të marrë masat e mëposhtme:
 - Të afishojë në vende të dukshme në mjetet e transportit, të drejtat e personave me aftësi të kufizuar për të udhëtuar sipas lehtësirave të parashikuara nga aktet ligjore apo nënligjore në fuqi dhe politikat e shoqërisë për ofrimin e udhëtimit me 50 % të çmimit të biletës për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar;
 - Të parashikojë në rregulloren e brendshme të shoqërisë dhe në kontratat individuale të punës, detyrimin e punonjësve për të trajtuar me dinjitet dhe pa diskriminim të gjithë personat me aftësi të kufizuar dhe respektimin e të gjitha të drejtave të parashikuara për këtë kategori;
 - Të kryejë trajnime për të gjithë punonjësit e shoqërisë, në lidhje me respektimin e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara. Rekomandohet që trajnimet e punonjësve të kryhen në bashkëpunim edhe me organizatat e personave me aftësi të kufizuara të cilat janë njohës të çështjeve dhe problematikave të personave me aftësi të kufizuara.
3. Shoqëria Transportit të udhëtarëve “Beam” shpk, brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e rekomandimeve të mësipërme.
4. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

(Shkaku: Aftësia e kufizuar)
(Fusha: Të mira dhe shërbime)